



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

RREGULLORE

MBI THEMELIMIN DHE STRUKTURIMIN E ASAMBLESË KOMUNALE TË FËMIJËVE

Klinë, Prill 2019

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2 nen c) të Ligjit për 'Vetëqeverisjen Lokale' Nr.03/L-040, publikuar ne Gazetën Zyrtare nr.28/2008 me datën 20.06.2008, Nenin 10 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Klinës, nr. 01-110-1232/2010 të miratuar më datën 31.3.2010, me propozimin e Drejtorisë Komunale të Arsimit, Kuvendi i Komunës së Klinës, në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur më datën 30.04.2019, miraton:

RREGULLORE

MBI THEMELIMIN DHE STRUKTURIMIN E ASAMBLESË KOMUNALE TË FËMIJËVE

DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Qëllimi i Rregullores

Përmes kësaj Rregulloreje parashihet që nga të gjitha Shkollat Fillore te Mesme të Ulëta, më tutje SHFMU, të delegohen përfaqësuesit e zgjedhur për Asamblenë Komunale të Fëmijëve.

Neni 2

Qëllimet e Asamblesë

1. Pjesëmarrja aktive në zhvillimin dhe realizimin e veprimeve në fushën e arsimit, shkencës, kulturës, sportit, punës humanitare dhe aktiviteteve të tjera me interes për fëmijët dhe komunitetin;
2. Zhvillimi i bashkëpunimit me Këshillat Drejtues të Shkollave, Këshillat e Prindërve, Këshillat e nxënësve dhe komunitetin lokal;
3. Krijimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit me mekanizmat dhe organizatat tjera;
4. Ngritja e vetëdijes për të drejtat e fëmijës, përgjegjësitë dhe gjithë përfshirja e interesave të fëmijëve/nxënësve;
5. Avokimi mbi çështjet të ngritura nga vetë fëmijët;
6. Organizimi dhe pjesëmarrja në aktivitete të identifikuar nga vetë fëmijët, dhe ato që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve;
7. Inkurajimi i tolerancës, solidaritetit dhe demokratizimi;
8. Promovimi i vlerave shoqërore.

Neni 3

Kompetencat

1. Obligimet dhe detyrat e Asamblesë:

1.1. Dhënien e kërkesave, mendimeve dhe sugjerimeve për institucionet relevante Komunale, për Këshillat e Shkollës, Këshillat e Prindërve, dhe Drejtoritë, lidhur me zbatimin e rregulloreve të sjelljes në shkollë, planin e zhvillimit të shkollës, aktivitetet e lira, pjesëmarrjen në sporte dhe konkurse të tjera dhe organizimin e të gjitha manifestimeve të nxënësve në shkollë dhe jashtë saj në interes të fëmijëve;

1.2. Të siguroj bashkëpunimin e nxënësve dhe mësuesve, edukatorëve dhe bashkëpunëtorëve profesional;

2. Informimin e nxënësve rreth çështjeve me rëndësi të veçantë për arsimimin e tyre përmes komunikimit të rregullt me këshillat e shkollave.

Neni 4

Organizimi i Asamblesë

1. Njësia për të drejta të njeriut (NJDNJ) e ndihmon, monitoron dhe raporton për punën e Asamblesë;

2. Organet e Asamblesë janë: Kryetar-ja/i, Kryesia e përbërë nga 5 persona, dhe Komisione të organizuara dhe përzgjedhur nga vetë asamblistët;

3. Zyrtari për të drejta të fëmijëve nga NJDNJ në nivel komunal organizon zgjedhjet për Asamble në koordinim me DKA;

4. Përfaqësimi i nxënësve në Asamble bëhet nga një përfaqësues në çdo shkollë proporcionalisht me numrin e nxënësve në secilën shkollë;

5. Përfaqësuesit e deleguar në Asamble zgjidhen në SHFMU përmes procesit zgjedhor në fillim të vitit shkollor dhe përfshin nxënësit e klasave gjashtë-tetë (6-8);

6. Numri i fëmijëve në Asamble duhet të jetë i njëjtë me numrin e anëtarëve të Kuvendeve Komunale të Komunës gjegjëse.

Neni 5

Vendimet e Asamblesë

1. Asambleja merr vendime për arritjen e qëllimeve të përcaktuara dhe miraton:

1.1. Planin vjetor të punës së Asamblesë;

1.2. Rregulloret e brendshme si dhe ndryshimet në rregullore;

- 1.3. Zgjedh dhe shkarkon kryetarin e Asamblesë;
- 1.4. Shqyrton dhe miraton së paku një raport vjetor të punës së Kryesisë dhe komisioneve;
- 1.5. Shqyrton dhe miraton propozimet e anëtarëve të Asamblesë dhe komisioneve.

Neni 6

Mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve për Asamblatë

1. Në takim të përbashkët Këshilli i nxënësve fiton Kryesinë e klasave nga 6-8;
2. Nga të gjithë nxënësit e ftuar në takim përzgjidhen përfaqësuesit për asamblenë me votim të fshehtë, sipas Nenit 4, par.4.4, të kësaj Rregulloreje;
3. Secili nxënës prezent në takim ka të drejtë të propozojë dhe të jetë i propozuar;
4. Secili nxënës ka të drejtë të deklarohet se a pajtohet të jetë kandidatë përfaqësues i shkollës për Asamble;
5. Nxënësit e kandiduar për përfaqësues të Asamblesë, paraqiten me një fjalë rasti;
6. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet përmes procesit të votimit, të hapur ose të mbyllur;
7. Përzgjedhja e asamblistëve bëhet në javën e tretë të tetorit, në çdo dy vite;
8. Duke respektuar kuotën gjinore dhe gjithë përfshirjen, përzgjidhen kandidatët të cilët kanë numrin më të madh të votave (varësisht nga numri i asamblistëve që do të përzgjidhen);
9. Nëse ka numër të barabartë të votave, atëherë shkohet në raundin tjetër, Komisioni zgjedhor është gjithëpërfshirës.

Neni 7

Mbledhjet e Asamblesë

1. Katër mbledhje të Asamblesë janë obligative gjatë një viti kalendarik, ndërsa nëse është e nevojshme edhe më shpesh, me propozim të Kryetarit, Kryesisë, si dhe me iniciativën e një të tretës të anëtarëve të Asamblesë;
2. Asambleja vendos me shumicën e votave të anëtarëve prezent;
3. Anëtarët informohen përmes postës elektronike dhe formave tjera për pikat e rendit të ditës, kushtet e seancës si dhe informata shtesë;
4. Kuorumi për mbajtjen e mbledhjeve është gjysma, plus një (shumica e thjeshtë).

Neni 8

Përgjegjësitë anëtarëve të Asamblesë

1. Anëtarët e Asamblesë kanë mandat dy vjeçar, dhe mund të rizgjidhen në të njëjtin funksion;
2. Mandati i anëtarëve të Asamblesë përfundon me dorëheqje, pas përfundimit të mandatit ose mungesës pa arsye në tri seanca radhazi;
3. Asambleja raporton me shkrim tek NJDN;
4. Secili anëtar i Asamblesë njofton Këshillin e Nxënësve në shkollën e vet për punën e Asamblesë.

Neni 9

Të drejtat e anëtarëve të Asamblesë

1. Një anëtar i Asamblesë ka të drejtë:
 - 1.1. Të marr pjesë në arritjen e objektivave të Asamblesë;
 - 1.2. Të marr pjesë në punën e Asamblesë në kushte të barabarta me anëtarët e tjerë;
 - 1.3. Të propozon projektet, veprimet, dhe dokumentet e tjera të Asamblesë për vendimmarrje;
 - 1.4. Të marr pjesë në realizimin e të gjitha aktiviteteve të asamblesë;
 - 1.5. Të informohet në kohën e duhur për punën dhe aktivitetet e Asamblesë;
 - 1.6. Të shprehet lirshëm;
 - 1.7. Të kërkojë dhe të marrë informata nga Kryesia për çështje të rëndësishme në lidhje me ushtrimin e funksionit të asamblistit të ri;
 - 1.8. Të ketë vetëm një propozim për një çështje të caktuar;
 - 1.9. Të shfrytëzojnë ambientet e Asamblesë që u janë dhënë në dispozicion për punë dhe takime, në bashkëpunim me Komunën- Kuvendin e Komunës.

Neni 10

Detyrat e anëtarëve të Asamblesë

1. Anëtarët e Asamblesë janë të detyruar të:
 - 1.1. Kontribuojnë në mënyrë aktive në arritjen e objektivave;
 - 1.2. Marrin pjesë në përputhje me interesat e zgjedhësve në aktivitetet e Asamblesë;
 - 1.3. Ta respektojnë njëri-tjetrin;

- 1.4. Kryen detyra të tjera që i janë besuar atij/asaj nga Asambleja;
- 1.5. T'i përgjigjen ftesës së Kryetarit/es së Asamblesë lidhur me punë e Asamblesë;
- 1.6. Të nënshkruhen në fillim dhe mbarim të seancës për praninë e tyre;
- 1.7. Me shumicë votash ta aprovonjë, ndryshonjë apo plotësojnë rendin e ditës të propozuar nga Kryetari;
- 1.8. Të votojnë me shumicë votash propozimin e arsyetuar për shtyrjen apo tërheqjen e pikave të caktuara të rendit të ditës.

Neni 11

Mënyrat e votimit

1. Votimet mund t'i bëjë me vota të hapura ose të mbyllura, këtë e vendosin asamblistët;
2. Votimi i hapur bëhet me ngritjen e dorës, ndërsa Votimi i mbyllur (fshehtë) bëhet me fletëvotime. Votimin e fshehtë e udhëheqë dhe monitoron Komisioni i votimit;
3. Para se të fillohet me votim të fshehtë, Asambleja propozon dhe zgjedhë tre (3) anëtarë të Komisionit për numërimin e votave dhe për gjetjen e parregullsive në votime;
4. Konsiderohet i pavlefshëm fletëvotimi prej të cilit nuk mund të konstatohet më saktësi se si ka votuar asamblisti;
5. Pjesëmarrësit në votim, kanë vetëm një (1) herë të drejtë të votojnë;
6. Seancat janë të hapura dhe publike.

Neni 12

Zgjedhja e Kryetarit/es dhe Kryesisë së Asamblesë

1. Asambleja zgjedh një (1) Kryetarë, dy (2) Nënkyetarë, një (1) Sekretarë, një (1) Arkëtarë;
2. Të dy Nënkyetarët propozohen dhe zgjidhen nga anëtarët e asamblesë duke votuar;
3. Sekretari dhe arkëtari propozohet nga kryetari i asamblesë dhe votohen nga Asambleja;
4. Zgjedhja e Kryetarit/es bëhet me vota të hapura ose të mbyllura;
5. Kryetari/ja i/e sapo zgjedhur pas fjalimit të tij/saj rreth objektivave përgjatë punës menjëherë hapë votimin për përzgjedhjen e Kryesisë (Nënkyetarëve, sekretarit/es, arkëtarit/es);

Neni 13

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e kryetar-it/es së asamblesë

1. Kryetar-i/ja ka mandat të plotë 2 vjeçar nga momenti i zgjedhjes së tij/saj;
2. Kryetar-i/ja mund të bëjë propozime dhe ka të drejtë vote, dhe në rast të votimit të barabartë vota e Kryetar-it/ës është një votë më shumë;
3. Ka të drejtë të ndërpresë seancën nëse ka parregullsi;
4. Ka të drejtë ta largojë asambleist-in/en nga salla nëse ka shkelur Kodin e Mirësjelljes;
5. Kujdeset për zbatimin e Rregullores së Punës dhe për përmirësimin e kushteve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve;
6. Kryetari/ja duhet ta thërret mbledhjen së paku katër herë në vit, apo sipas nevojës;
7. Kryetari/ja nuk duhet të mungojë në tre (3) mbledhje radhazi, po qe se ai/ajo mungon pa arsye, atëherë mund të kërkohet edhe shkarkimi i tij/saj;
8. Kryetari/ja nuk guxon të bëjë anime(ndarje), Nëse Kryetari/ja mungon, vazhdon seanca me Nënkryetarin/en i/e parë;
9. Nëse mungon edhe Nënkryetari/ja i/e parë, atëherë vazhdon me të dytin;
10. Nëse Kryetari/ja bën shkelje të Rregullores së Punës dhe Kodit të Mirësjelljes, ai/ajo mund të shkarkohet me votimin e 2/3 të asamblistëve.

Neni 14

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nënkryetarëve

1. Asambleja duhet të ketë 2 Nënkryetarë;
 - 1.1. Nënkryetari i dytë duhet të përzgjidhet nga komunitetet jo-shumicë;
 - 1.2. Nënkryetar-i/ja i Asamblesë i ndihmon Kryetarit/es në kryerjen e punëve dhe kryen punë të tjera nga fushëveprimet e tij/saj;
 - 1.3. Me autorizimin e Kryetarit, mund ta zëvendësojë atë brenda dhe jashtë vendit, varësisht nga agjenda e takimit.

Neni 15

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e sekretarit/es

1. Sekretari/ja i/e Asamblesë bën pjesë në Kryesi dhe ka detyrat e përcaktuara;
2. Sekretari/ja me kërkesë të Kryetarit thirr seancën, cakton datën, orën dhe vendin e mbajtjes së seancës dhe mban procesverbalin;
3. Ruan dokumentet e Asamblesë, dhe ë bën evidentimin e prezencës të asamblistëve;

4. Sekretari ka përgjegjësi të monitorojë implementimin e planit të veprimit të Asamblesë.

Neni 16

Detyrat dhe të drejtat e Kryesisë së Asamblesë

1. Kryesia e Asamblesë zgjidhet nga vet asamblistët dhe duhet të jetë e përbërë nga pesë(5) anëtarë;
2. Anëtari/ja i/e Kryesisë nuk mund të ketë më shumë se një post;
3. Mbajnë shënime dhe shfaqin idetë e tyre për të mirën e fëmijëve;
4. Cakton rendin e ditës në bashkëpunim me anëtarët e Kryesisë, (nënkryetarët, sekretari/ja, arkëtari/ja në krye me Kryetarin/en);
5. Harton plan programin dhe kalendarin e punës;
6. Vendimet e Kryesisë miratohen nga asamblistët.

Neni 17

Komisionet

1. Komisionet janë organe të përkohshme ose të përhershme që kujdesen për zbatimin e objektivave të Asamblesë;
2. Komisionet që janë organe punë të përhershme:
 - 1.1. Komisioni për bashkëpunim me organet profesionale të shkollës, këshillin e shkollës, këshillin e prindërve, mësuesit dhe komunitetin lokal;
 - 1.2. Komisioni për sport dhe kulturë;
 - 1.3. Komisioni për veprim humanitar;
 - 1.4. Komisioni për informim;
 - 1.5. Sipas specifikacioneve të Komunës;
3. Vendimi mbi themelimin, përgjegjësit, shuarjen e komisioneve miratohet nga Asambleja në interesin më të mirë të fëmijëve;
4. Çdo komision ka udhëheqësin e vet, i cili/a që zgjidhet me votim brenda komisionit.

Neni 18

Komisionet dhe detyrat e tyre

1. Komisionet i kryejnë të gjitha punët dhe detyrat sipas planit të veprimit;
2. Plani i veprimit të çdo Komisioni duhet të aprovohet nga Asambleja;
3. Komisionet mbajnë mbledhjen e përgjithshme me Kryesinë;
4. Shkarkimi i komisioneve bëhet nëse nuk respektojnë dhe nuk mbajnë përgjegjësi për punën e tyre.

Neni 19

Procesverbali

1. Për punimet e seancës së Asamblesë Komunale të Fëmijëve mbahet procesverbali (shih Neni 15);
2. Procesverbali i përmban të dhënat kryesore për punimet e seancës, propozimet e paraqitura dhe konkluzionet e miratuara në lidhje me çështjet e rendit të ditës;
3. Procesverbali sipas rregullit, i shpërndahet nëpërmes postës elektronike dhe mënyrave tjera të gjithë asambleistëve më së voni një (1) ditë para seancës që do të miratohet;
4. Sekretari/ja i/e Asamblesë ka për detyrë përgatitjen dhe ruajtjen e procesverbaleve origjinale të seancave të Asamblesë.

Neni 20

Publikimi dhe njoftimi

1. Puna e Asamblesë është publike, ku të gjitha procesverbalet, planet e veprimit, minutat e takimeve, publikimet, dhe çfarëdo e dalë nga asambltetë, publikohen në ueb-faqen e Asambleve (<http://akf-ks.org/>) dhe mbikëqyrët nga NJDNJ.
2. Kryesia kujdeset për informimin e rregullt të anëtarëve dhe publikut për punën dhe aktivitetet e Asamblesë, qoftë drejtpërdrejt, komisionit për informim ose përmes publikimit të aktiviteteve.

Neni 21

Bashkëpunimi

1. Për të arritur qëllimet, Asambleja krijon kontakte dhe bashkëpunon me shoqatat dhe organizatat e tjera profesionale, shkencore, arsimore dhe të ngjashme;
2. Asambleja bashkëpunon dhe koordinohet me Komunën/Kuvendet Komunale.

Neni 22

Mjetet dhe financimi

1. Mjetet e nevojshme për funksionimin dhe financimin e aktiviteteve realizohen përmes:

1.1. Planifikimit buxhetor nga kategoria mallra dhe shërbime, subvencione nga programet nga Zyra e Kuvendit komunal, Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria e Arsimit;

1.2. Mbledhjes së fondeve, shkollat, kontributet vullnetare të nxënësve, mësuesve, prindërve dhe donacionet nga organizatat e biznesit, si dhe donatorë të tjerë.

Neni 23

Modifikimi i Rregullores

Ndryshimet në Rregullore janë të mundshme në bazë të propozimit të një të tretës së anëtarëve të Asamblesë.

Neni 24

Pushimi i punës së Asamblesë

Asambleja pushon së punuari me vendimin e shumicës së anëtarëve, kur pushojnë kushtet për arritjen e objektivave.

Neni 25

Dispozitat përfundimtare

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset Njësitë për të Drejtat e Njeriut, Drejtoria Komonale e Arsimit, Drejtoria e Financave si dhe Drejtoritë tjera Komonale.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përkatësisht 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunesë së Klinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

Klinë, dt. 03/05/2019

01Nr. 06-17767/2019



Kryesuesi,
Fadil GASHI